

**18.03.2023
Ora 12:56**

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat ankimore nr. 34, subjekti ankues
Bindja Demokratike dhe 35, subjekti ankues LZHK”.**

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot datë 18 mars 2023 zhvillohet shorti për caktimin e relatorit kërkesa ankimore numër 34,35 me kërkues Partia Bindja Demokratike për kërkesën ankimore numër 34 dhe për kërkesën ankimore numër 35. Ankues është LZHK-ja e cila kundërshton vendimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 173. Në vijim referuar dhe nenit 14 rregullores së KAS-it kemi përgatitur 5 shirita letre ku në dy shirita janë shkruar numrat e kërkeses ankimore numër 33, 34, tre shiritat e tjerë janë të bardha dhe pa shënime të cilat një përfaqësues i KQZ-së do t'i palosë dhe do t'i fusë në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Duke qenë se antarët e KAS-it nuk janë prezent atëherë një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqë në emër, për llogari të tyre goglat e futura në një enë transparente, vazhdojmë me pjesën numër 35. Pasi janë futur 5 goglat në enën transparente do të përzgjidhen nga përfaqësues i KQZ-së e cila do të tërheqi në emër për llogari të tyre sipas rendit alfabetik rritës, nga zoti Ervin Lako i pari.

Z. Ervin Lako - kërkesa ankimore numër 34.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.03.2023*

Z. Elvis Çefa: -Tërhiqet gogla -Kërkesa ankimore numër 35 me relator zotin Elvis Çefa.

- Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. Ilirjan Rusmali: - Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

- Vazhdojmë në emër dhe llogari te:

Z. Koli Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në fund, në emër dhe llogari të:

Z. Ledio Braho: - Edhe këtu shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit relatoi kërkesën ankimore numër 34 është zoti Ervin Lako dhe relatori i kërkesës numër 35 është zoti Elvis Cepa, ju, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

